



Datë: 22.04.2025
Numër Protokolli : 2728/2025

A.nr. 343/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.343/2025, të datës 20.02.2025, të parashtruar nga ankuesja A.K, kundër organit të punësimit/ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *shpallet jo kompetent* për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.343/2025, të datës 20.02.2025, të parashtruar nga ankuesja A.K.

II. Çështja bije në kompetencë të Gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesja, A.K (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 20.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër protokolli 409 të datës 18.02.2025, të Komisionit për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe ankesave tjera në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.343/2025, të datës 20.02.2025, të parashtruar nga ankuesja Afërdita Krasniqi, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër Ref:4/4-6, është e punësuar në pozitën *Pastruese*, pranë Sektorit të Inspektoratit të Arsimit në Prishtinë, në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe sipas Vendimit me Ref:10 dhe numër protokolli 1187 të datës 01.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit, e njëjta është caktuar në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së punëve të shërbimeve postare, dërgimit të materialit në të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës si dhe detyrave tjera të rëndësishme të organit përkatës të punësimit.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas përgjigjes me numër protokolli 409 të datës 18.02.2025, të Komisionit për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe ankesave tjera në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, rezulton se ankuesja më datë 07.02.2025 kishte parashtruar kërkesë tek ky Komision, i cili rrjedhimisht ka njoftuar të njëjtën se Komisioni nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj ankesë, duke konstatuar se ankesa duhet të dërgohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër përgjigjes me numër protokolli 409 të datës 18.02.2025, të Komisionit për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe ankesave tjera në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, kërkon trajtimin e ankesës së saj si punëtorë me përvojë pune prej 21 vitesh në Inspektoratin e Arsimit, duke theksuar ndër të tjera se nga viti 2015 është angazhuar në detyra tjera, pa ndryshim titulli apo koeficienti të pagës, ashtu që sipas ankueses vetëm pozita e saj ka mbetur e pa definuar.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranueshmerisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 5 paragrafi 5 ku përcaktohet se: *5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike..*, dhe si rrjedhojë konstatoi se ankuesja për shkak të pozicionit të punës që mbanë aktualisht si *Pastruese* pranë Sektorit të Inspektoratit të Arsimit në Prishtinë, në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nuk e ka statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, por i njëjta e gëzon statusin e ***Nëpunësit teknik dhe mbështetës*** sikurse përcaktohet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.343/2025, të datës 20.02.2025.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.343/2025 të datës

20.02.2025, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën kompetente.

Kështu që thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.343/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.K;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Arkivit të KPMSHCK-së